

PËRLESHJE *me* Përbindëshin E ZJARRTË

19
2
188-196

~~84-129~~
FUAT SARAÇI

~~BIBLIOTEKA E SHTETITI
GJIROKASTER~~
2271

**PËRLESHJE ME PËRBINDËSHIN
E ZJARRTË**

**BOTIM I KOMITETIT QENDROR TË BASHKIMIT
TË RINISË SË PUNËS SË SHQIPÉRISË
TIRANË, 1958**

S'ka ndryshim, s'ka pérparim, s'ka reallizim nē vendin t'onë që tē mos ketē markën e rinisë, që tē mos ketē kulluar nē tē djersa e rinisë, që tē mos jetë sbkrirë nē tē dituria, guximi, sakrifica, patriotizmi i shkëlqyer i rinisë s'onë. E reja ndërton tē renë, ështëjeta e re që ngribet pér tē rinjtë, vrulli dbe entusiazmi i tē cilëve i bën pleqtë tē rinj.

ENVER HOXHA

Me 22 Prill 1957 në zonën e re të naftës në Marinzë (Patos) brigada e rinisë «Miqësia me Bashkimin Sovjetik» filloi punën për çeljen e pusit Nr.542, nga i cili plasi naftë me erupsion të fuqishëm...

NË MARINZË...

Patosi është i shpërndarë midis kodrash të veshura me drurë të shkurtër dhe plot gjethë. Në disa vende ka grumbuj ullinjsh të motshëm. Por ata që bijen më tepër në sy janë kullat e nalta të puseve të naftës të shpërndara nëpër majë, faqe kodrave që zbresin deri buzë fushës në Marinzë. Mori tubash pëershkojnë kodrat. Nëpër to kalon nafta, që nxirret nga thellësit e nëntokës...

Në mëngjezin e një dite Prilli të vitit 1957, nga shkallët e një ndërtese të re, zbriti një djalosh trup mesatar, por të lidhur mirë. Ay shtriu krahët dhe mori frymë thellë, duke mbushur krahanorin me atë aqin e pastër të mëngjesit pranveror. Pastaj ferkoi pëllëmbët me njëra tjetrën dhe eci shpejt. Fytyra e tij dukej më e qeshur se ditët e tjera. E kjo u ra në sy naftëtarëve, që e shihnin mëngjes për mëngjes kur ngjitej lart në sheshin e automjeteve. Shëkimeve të tyre pyetës, djaloshi u shmangej dhe vazhdonte rrugën. Tek sheshi priti një copë herë. Koha po kalonte dhe njeri nuk dukej, bile as shofëret s'shiheshin gjëkund. «Si është kjo punë kështu? Sot që të gjithë duhet

nonte natë e ditë. Besimi i math në forcat e të rinjve e bënte Qemalin të dilte gjithmonë ballë hapët para ndërmarrjes dhe t'a mbante burrërisht fjalën që jepte. . .

— Tani më duket, më takon mua t'ju them një dy fjalë, shokë të dashur të rinisë — tha drejtori — Unë e dij se brigada e juaj është brigadë punëtore. Kam pasur dhe gjithënjë e kam shtuar besimin në forcat tuaja. Bile ju kam edhe zili për zellin, vullnetin, dituritë dhe forcat tuaja. Zaten është e qartë, se tek ne po rritet një brez i fuqishëm naftëtarësh. Dhe ju i takoni këtij brezi. Partia ju ka dhënë një besim të math. Dhe ajo është e bindur se do t'i delni në krye, desha të thosha se jini të denjë të besimit. Puna po ju kalit. Po ju bën djem të fortë, të pa përkulur, të devotshëm.... Më falni shokë të rinisë. Unë po ju them fjalë të tillë jo për t'ju bërë qefin, se sa për t'ju kujtar se e mira duhet t'ju çojë tek më e mira. Atë që kemi duhet t'a shtojmë dhe atë që s'e kemi duhet t'a gjejmë, se sukseset duhet të na nxitin për fitore të reja. Dhe këtë besim unë e kam tek ju.... Ju uroj punë të mbarë, shokë të rinisë. Ju uroj të ecni në gjurmat e Kップlan Hajdarit, dhe bile, do të dëshiroja të bëhenhit rivalë të tij. Forcat ju i kini, mjafton që ato t'i grumbulloni dhe t'i organizoni më mirë....

Folën edhe shokë të tjera specialistë të ndërmarrjes. Ata u treguan të rinjve se me ç'farë toke kishin të bënин dhe cili do të ishte procesi teknologjik i çpimit. Kështu mori fund festa e punës dhe tani do të fillonte çpimi.

.... Antarët e brigadës u shpërndanë nëpër vendet e caktuara.. Me një vërvshëllim të fortë të mjeshtërit, motorët buçiten. Saraqineska filloj të rrötullohej.

Mysafirët u larguan. Zhurma e motorit të gazeve as që u ndje fare. Ajo mbytej midis ulurimës së motoravet në skelën e pusit. Saraqineska vërtitej me shpejtësi të madhe e tubi katror shkonte thellë e më thellë. Skarpolloja gry-

ente tokën e sulina ngjishet gjithnjë e më shumë. Argjili çimetonte tokën për rrëth tubit.

Ditën e parë, të dytën e të tretën, brigada e vu punën përparrë. Toka ishte e butë e çpimi ecte me shpejtësi. Ama edhe të rinxjtë bridhnin nga një vend në tjetrin, i ndihnin shoku shokut. Kur duheshin pastruar motorët, e gjithë brigada mblidhet rrëth tyre. Disa bënin pastrimin, të tjerë i vaisnin me qëllim që të mos ngada'ëschej puna. Brigada e rinis vepronë sikur të ishte një njeri i vetëm. Kështu që vendosur në mbledhjen e fundit të organizatës së rinisë. Çështja ishte që të tejkalohej sa të ishte e mundur më shpejt plani i çpimit. Pjesa e tejkaloar ishte rezerva e brigadës: Eksperiencia e mësoi që brigada të vepronë gjithnjë kështu, sepse në nëntokë, me gjithë të dhënat e gjetje logjisë, prapë se prapë mund të dëshin pengesa që nuk ishin paraparë.

Kryesondatori, Ilija Minella, që është edhe sekretar i organizatës së rinisë, qëndronte vazhdimisht pranë sarqineskës.

— Ndal, ndal, ndal, — bërtiti pa pandehur ay.

Motoret menjëherë u shuan. Disa nga antarët e brigadës kujtuan për avari, por me të parë Ilijan u qetësuani.

— Ç'pate, Ilija? — i tha Qemali që i kish duart gjithë argjil.

— Asgjë, shoku brigadier....

— Po pse i ndale motorët?

— Si pse! jo nga qefi, po.... — dhe i tregoi mendorë tubin katror.

Tubi i dhjetë ishte futur deri në buzë, prandaj duheshe vendosur një tub tjeter, ashtu siç ishte vepruar edhe më përparrë.

— Qemali, pasi lau duart, mori katalogun që tregonte përbërjen e tokës poshtë dhe lajmëroi Ilijan të merrte masa, që pas tubit të dhjetë të ndrohesh skarpelloja.

— Nuk është shpejt shoku brigadier? — pyeti Ilija.

— E, është pak shpejt, por nuk është keq të pregaritemi para se të marrim sinjalin. A thamë që do të matrim masa paraprake për çdo punë, a po jo?

Ilija nuk foli. U dha shenjë me dorë Bilalit dhe Rifatit që të sillnin skarpellon kokë peshku, e cila përdoret për shpuarjen e shkëmbinjve të nëntokës.

... Por ja, nuk kaluan as dy ditë dhe fytyrat e qeshura të të rinjvet filluan të ndrrojnë pamje. Një shkëmb i fortë si të ish hekur pengoi shpimin më shumë se sa parashikohej. Rezervat e brigadës filluan të paksohen. Për disa ditë rresht përparimi i çpimit ishte shumë i ngadalshëm. Arriti puna sa që e gjithë rezerva të zhduket dhe bille të preket dhe plani i caktuar. Grafiku i realizimit të planit cdo orë ulej. Brigada po shqetësohej. Por s'kishte se ç'të bënte. Deri sa të çpohej shkëmbi, çdo masë nuk sillte dobi.

Në një ditë Maji, përsëri ishte Ilija, që bërtiti me të madhe:

— Mbaoi, mbaroi, mbaroi, — shokë!

Në pusin 542 vlonë puna. Enthusiazmi i të rinjve tritej çdo ditë...

Vera kish ardhur pak si e nxituar dhe ato ditë filloj të bëjë vapë. Të rinjtë rrinin me kanatiere dhe aty nga mezi i ditës ishin gati t'i hiqnin dhe ato. Djersët u kullonin çurkë, lëkura e trupit të tyre po merrete pak e nga pak ngjyrën e kafesë. Vapë, lodhje, etje për ujë dhe kjo zhurma e vazhdueshme e motorave. Eh sikur mos të kish vapë dhe zhurmë... Po s'ka gjë, mjafton që skarpelloja ecte me shpejtësi drejt zemrës së tokës. Dalë nga dalë ajo po i afrohej shtresës së naftës. Ishin metrot e fundit. Tek pusi erdhi drejtori i ndërmarrjes. Ay dukej i entuziazmuar shumë. I kishin thënë se brigada e Rinisë «Miqësija», kish arritur rekorde të reja në çpim: Brenda 21 orëve ajo kish çpuar deri në 208 metro. Vetëm brenda 8 ditve radhazi kish arritur të çpojë 660 metro. Kjo i habiti të gjithë...

Realizimet e brigadës së rinisë vetë drejtori i ndiqte hap pas hapi. E në të njejtën kohë, shpesh e më shpesh pyeste laboratorin për rezultatet e analizave të pusit 542. Kryeinxhinieri Piro Bozo, dhe inxhinierët sovjetikë Surkovë dhe Valentini vinin aty pothujse për ditë. Përse vallë?

* * *

Ditët e fundit në pusin 542 maqinat venin e vinin. Një herë drejtori, një herë tjetër ingjinjeri: Disa herë erdhë dhe specialistë e ingjinjerë nga drejtoria e kombinatit të naftës «Stalin». Brigada e rinisë po i jepte fund çpimit. Ishin për t'u çpuar edhe një dhjetë metro.

Drejtori me gjith kryeinxhinjerin, atë ditë, nuk shkuan as për drekë, por qëndruan tek pusi. Të dhënat nga elektrometri ishin interesante. Kur mbaroi sasija e planifikuar e çpimit, u konstatua se aty gjëndej naftë. Por në bazë të llogaritjeve, kjo shtresë nafte ishte zbuluar nga pusi 325, që e kish çpuar po brigada e rinisë «Miqësija». Mirëpo aty drejtorja e kombinatit të naftës «Stalin» parashikonte të zbuloheshin shtresa të reja të panjohura.

Të nesërmen Qemalin e thirrën në një mbledhje në kombinat. Aty do të bisedohej rreth të dhënave të pusit 542 dhe të vendosjej se si duhej të veprohej, të bëhej porferimi, apo të vazhdonte më tej çpimi për të kërkuar shtresa të reja nafte. Po këtu kish edhe një rrezik. Në qoftë se do të vazhdohej çpimi mund të takohej një shtresë uji apo shkëmbi me trashësi të madhe dhe në fakt pusi do të delte i pa vlefshëm.

Pas diskutimeve të gjata, mbledhja vendosi të shpeshin akoma dhe 30 metro. Në fillim Qemali nuk e priti mirë këtë vendim ... Atij dhe gjithë brigadës do t'i mbej një plagë e përherëshme në zemër në qoftë se parashikimet nuk provoheshin ...

Mjeshtri u kthyë në brigadë jo plotësisht i vendosur. Në mendjen e tij rikujtonte punën e madhe që ishte bërë, shpenzimet e shumta, kohën e shtrenjtë flori, naftën...

Sapo mbrijti tek pusi, brigada e mori në mes. Seicili e shikon me vërejtje për t'u njohur me vendimin e marrë edhe pa folur Qemali. Por mjeshtri u tregua i përbajtur dhe nuk dha ndonjë shenjë shqetësimi.

— Shokë, kemi një urdhër të ri. Duhet të çpojmë akoma dhe 30 metro, — tha brigadieri me atë zënë e tij të qëtë dhe të vendosur.

Një murmuritje pakënaqësi e dëgjua në turmën e naftëtarëve. Fytyrat e të rinjve ndruan çere. Sejcili pa folur dha shenja shqetësimi...

— Këtë urdhër, — vijoi Qemali — ne do t'a zbatojmë ashtu si na ka hije. Ju e kuptioni se ndërmarrja bën kërkime për shtresa të reja të panjohura nafte. Për ne do të jetë gjë e madhe të zbulojmë një shtresë të tillë...

Dalë nga dalë të rinjtë ndjenë t'u largohej shqetësimi, që i pushtoi në fillim.

— Kështu pra, shokë. Të dhënat që ka gjeologjija t'a mbushin mëndjen se më poshtë me siguri do të ketë naftë. Vendi ynë, naftë nxjerr shumë. Por sa më shumë të nxjerrë aqë më mirë është. Pse të rrijnë gazi dhe nafta nën tokë?

— Po sikur të dalë ujë? Po sikur të mos dalë asgjë? — bërtiti me zemërim një nga të rinjtë.

— E po dale, mor shok — foli kësaj radhe Bilal Ruka, — daleni një herë të merremi vesh mirë. Këtu nuk luajmë kuku msheftas de. Ndërmarrja e ka studjuar mirë, e ka shoshitur në të katër anët dhe nuk është razi që shpenzimet, kohën dhe mundin tonë t'i hednë në henoekun e plehravet...

— I dimë ato, mos na i thuaj ti Bilal. Eu kam katër vjet unë këtu. E di ti se më përvëlon në zemër të humbasë edhe një kilogram naftë? Mua po më rrit nafta. Po them

de, se para nesh nuk është fushë me lule. Është luftë ~~dhe~~
kam të drejtë të flas ...

— Mos u nxeh ti, Xhevair. Po unë them tē mos e
zgjasim shumë këtë bisedë. Nuk ta pata pér tē keq ...

— Ejani pra shokë tē fillojmë — thirri Ilija — vendi
s'të thotë kurrë luaj ...

Motorët buçiten. Saraqineska zuri tē vërtitej e tē
ngjishte thellë skarpellon.

U çpuan nja is metro.

— Argjil — thiiri me tē madhe Ilija.

— Pse, ç'ngjet? — ndërhyri menjëherë Qemali.

— Nuk po mjafton argjili, shoku brigadier, — d'ë
vrapoi pér në kazanin e madh. Pér çudi aty kish a gil tē
mjaftushëm. Po pse atëhere ndihet mungesë argji? Mje-
shtri e kuptoi menjëherë. Sytë ju drodhë nga zërimi. Po
e mbajti vehten. Nuk iu duk me vend tē shqetësonte bri-
gadën. Mirpo kryesondatori me t'a parë më rë në fitye
zbuloi shqetësimin e tij. Në fund tē pusit, atje ku gryente
skarrelloja, do tē ndodhej ndonjë e çarë toke dhe njer
tē kalonte argjili. Kështu që çimentimi i pusit pengohej.
Vazhdoi kështu disa orë. Më në fund edhe ajo e çarë u
zu. Siç dukej ajo ishte e vogël dhe u zu shpejt me argjil.
Filloi përsëri çpimi normal.

Porsa tē zo metrot mbaruan, u shuan motorët dhe fi-
lluan preqatitjet pér porferim. Qemali i hipit maqinës dhe
shkoi tek drejtori.

Ishte errur. Sapo maqina po ngjiste kodrat e Patosit,
dritat u ndezën.

Trokiti në derë dhe hyri. Drejtori ishte krrusur mbi
ca shkresa dhe nuk u kujtua tē shikonte kush hyri në zyrë.

— Shoku drejtor! Të tridhjet metrot u çpuan ...

— Të lumtë Qemal.

— Shoku drejtor ...

— E di çdo tē thuash, hë pér hë lere me kaq. Nesët

bisedojmë dhe pregaitemi për porferim. Fjalën porferim mezi e shqiptoi. Po Qemali nuk kuptoi gjë.

Me t'u larguar Qemali, Polikroni mori në dorë dorëzën e telefonit. Pasi pshëretiu thellë bisedoi me drejtorin e përgjithshëm. I dha rezultatet e analizavet të bëra dhe priti urdhër.

— Shoku Ramis...

— Po, po, kuptova, Polikron. Nesër do të bisedojmë. Do të mundohem të vi andej...

... U dha urdhër që të çohen akoma dhe 50 metro ..

— Bobo, ç'po bëhet? — thirri njeri andej nga fundi ..

Por pa e bërë fjalën dysh ata shkuan nëpër vëndet e tyre. Qemali shtypi sustën dhe motorët buçitën.

Toka ish e butë. Të pesëdhjetë metrot u çpuan më shpejt se sa parashikohej. Pas pregaiteve për porferim, brigada e rinis la punën.

Ishte dita e 8 qershorit. Dielli digjte si prushi. Antarët e brigadës qëndronin me zemër në dorë. Ata prisnin me padurim porferimin dhe... naftën. Të gjithë e kishin kyçur gojën. Mornica u kalonin në trup. Pritej të plaste fontana. Ishte fundi i tërë asaj pune të madhe që u bë. Sejcili pyeste vehten: çfarë do të dalë vallë?

«SHATRIVANI...»

Të gjithë i kishin mbërthyer sytë grykës së pusit. Mendja e zemra e sejcilit tretej në 'të. E kjo vinte sepse kërkimet kishin kaluar përtëj shtresës të naftës së njojur. Tani pritej të ishte fitore e dyfishtë e naftëtarëve të brigadës së rinisë: në njëren anë se edhe këtë pus do t'a dorëzonin me naftë (sepse ka edhe raste që ndonjë pus nuk jep naftë) dhe nga ana tjetër zbulonin një shtresë të re naftë. Kjo ishte arsyaja, që të rinjtë mezi i mbante vendi deri sa të plaste fontana.

Fundi erdhi. Për një sekondë toka u drodh. Fontana plasi me një forcë të çuditëshme. Një zhurmë aqë e madhe nuk ishte dëgjuar kurrë ndonjë herë nga naftëtarët e vëndit tonë. Shpërthimi shurdhonjës dhe po aqë i vru lshëm përhapi me shpejtësi vetëtime, ujë e pastaj naftë. Sa të hapësh e të mbyllësh sytë u duk një erupsion i fuqishëm që llogaritej deri në 1500 atmosfera. Një shatrvan u ngrit vetëtimthi në qiellin e kaltërt dhe nafta bojë kafe e etët filloj të bjerë si shiu: E ajri për rrëth pusit u helmatis nga gazi.

Gryka e pusit villte me një fuqi përbindëshi naftë e gaz. Edhe disa qindra metra larg pusit të dukej vehtja sikur ishe mes motorësh reaktivë që ulurinin pa ndërprerje.

Buçitjet e tmerrëshme të pusit tronditen edhe zemrat e nënave dhe të afërmëve të naftëtarëve të rinj, që u ndodhë tek pusi eruptiv. Ato pandehën se i humbën të dashurit e tyre. Nga Patosi i ri dukej mirë ç'ndothte tek pusi §42. Përbrënda sondës një shatervan i madh. Një sitym i murmë kish pështjellë atë dhe ngjitej lart. Sa vinte, toka rrëth e përqark pusit, qindra metra lark tij, po nxihet nga nafta që binte si shi.

Një erupsion i tillë nuk ishte parashikuar. Kjo ishte një e fshehtë e nëntokës, prandaj dhe ndërmarrja nuk kish marrë masa përfrenimin e tij qysh në lindje.

Naftëtarët për disa çaste nuk e kuptonin se ku ndodheshin. Vërvshëlli shurdhonjës të çponte veshët e të trulloste. Të goditur nga vala e shpërthimit të pusit, ata kishin rënë dikush përmbyss, dikush në shpinë, por të gjithë kishin zënë kokën me dorë si të mbroheshin nga ajo e pa pritur. Ata ndjenin sikur po ju merrej fryma, sikur zemra u qe egërsuar dhe po rrihte me aqë shpejtësi sa nga çasti në çast do të pëlciste.

Posa e mblodhi vehten Qemali, ktheu fytyrën nga pusit. Një vërvshëllimë e fortë, që vinte q'andej, iu duk sikur e preu si brisk. Me sy gjysmë të mbyllur u zvarit

pranë dy shokëvet që në fillim nuk i njoihu cilët ishin. U mundua t'i ngrinte, por ata sapo ndjenë dorë njeriu si kur u përmëndën përnjëherësh.

— Gjallë, gjallë jam! — thirri së pari njeri e pastaj edhe tjetri:

— Mua m'u hap koka.

— Shpejtoni për në qafë — u thirri Qemali.

— Po shokët?

— Mitë janë të gjithë, po nisuni, — u tha Qemali si për t'i kandisur që të largoheshin sa më parë. Para Qemalit duallë Ilija me Bilalin. Ata kishin marrë një shok në krahë dhe po shpejtonin.

— Mos u ndalni, ikni sa më shpejt — u thirri brigadieri.

Me të dalë në qafë të dy shokët ia dorëzuan infermierit atë që mbanin në shpinë dhe muarrë me të shpejtë tatëpjetë.

Në qafë mbritën naftëtarë të tjerë nga Patosi e u vërsulë në drejtim të pusit. Sapo ndjenë erën e naftës, iu duk sikur po iu zihej fytì. Pas pak e ndjenë vehten si të prerë dhe të pafuqishëm.

...Para ambulancës ishte mbledhur një turmë e mëdha njerëzish. Seicili mundohej të siguronte vehten në se të gjithë shokët ishin shëndoshë. Dhe e vërteta ashtu ishte. Pas kurimit naftëtarët filluan t'i buzëqeshnin njeri tjetërit dhe çfaqnin gëzimin përfitoren e re dhe të jashtëzakonëshme, që arriti Brigada e rinisë «Miqësija». Një fitore të tillë nuk e kish arrijtur asnje brigadë tjetër e ndërmarrjes së çpimit.

Pranë ambulancës ardhë edhe drejtonjësit e ndërmarrjes. Polikroni duke shkelur urdhërat e mjekut hyri me një frymë. Rrotulloi sytë me të shpejtë. Ay kishte përgëzuar shumë anëtarë të brigadës, po nuk po shikonte gjékundi Qemalin. Sytë i qenë errur. Parandjeu sikur Qemali ...

24192

Po jo. Ay po mjekohej i fundit. Ishte zverdthur në fytyrë dhe mezi merrte frysë. Siç duket gazi e kish dëmtuar më tepër se të tjerët... Polikroni e pushtoi më ato krahët e tij të gjatë. Pas mjekimit e mori për krahut për t'a shoqëruar në tendën e të sëmurve që ishte ngritur menjëherë.

Pusi dukej ende i veshur si me një vello tyli të murmë. Sonda dukej qartë. Gryka e pusit villte pa pushim naftë e gaz. E pasi e dërgonte disa dhjetra metro lart, gazi përhapej në hapësirë dhe tretej në ajr. Edhe aty në qafë njerëzit u lagën dhe u bënë quall. Secili kishte tretur shikimin në pus dhe i dukej sikur s'kish për t'u ngopur kurrë duke parë shatrvanan. Skela nën këmbët e sondës, tubat e gjithçka tjetër dukeshin si të tulitur, të nxirë.

Toka u ngop së thithuri naftë. Tani filluan të duken vija të degëzuara që rjedhin lëngun e zi, e aty këtu filluan të formohen pellgje nafte. Ato shumoheshin për herë e më tepër. Gjithkund shihej naftë. Shihnde atë naftë që brigada e finisë e nxori nga thellësitë e nëntokës s'onë, atje ku fshihen thesare... Naftëtarët sodisnin me dashuri arin e zi që nxirte pusi 542.

Lajmi i shpërthimit të erupsionit u përhap si vetëtinë. Gjithkush filloj të llogarisë forcën e pusit, vlerën e naftës, të ardhurat e mëdha që i siguroheshin popullit. Dikush thosh se nga pusi dalin dhjetra ton në orë, të tjerë thoshin edhe qindra, pati edhe prej atyre që thoshin me mijra...

Naftëtarët filluan të hapin gropë të mëdha, dhjetra metro katrore. Në këto gropë duheshe të grumbullohej hë për hë nafta, me gjithse dëmi ish i madh nga që një pjesë e thithë toka dhe një pjesë tjetër avullonte. Po këto as llogariteshin përpëra rezervave që duhej të kish pusi.

Sidoqoftë duar kryq s'duhej ndenjur. Kombinati mori masa sigurimi. Ndërkohë vazhduan konsultat për zënien e pusit. Po kjo ishte shumë e vështirë. Ndërmarrja dispononte mjetet e nevojshme për zënien e pusit. Po rrëziku-

i zjarrit nuk mund tē eliminohej kollaj. Këtu nuk është fjala se mund tē shkakëtohej zjarr nga njeri, ose nga shkëndijat e skapamentove tē maqinave apo traktorëve, por zjarri shkaktohej menjëherë edhe nga férkimi i metal-levet. Dhe sigurisht zënja e pusit do tē bëhej me metal. Këtu pra qëndronte vështirësija më e madhe. Veç këtyre, punonjësve t'onë tē naftës, u mungonte eksperiencia për tē ndërmarrë veprime për zénien e pusit. Ata vetëm kishin dëgjuar se kanë ekzistuar puse eruptive, por asnjëherë nuk kishin parë me sytë e tyre.

Po si do t'i bëhej halli, atëhere?

Qysh tē nesërmen, u muarë masa për grumbullimin e naftës me anën e hapjes së kanaleve tē vegjël në drejtëtim tē gropave tē mëdha, tē cilat po çeleshin disa qindra metro larg pusit. Prej aty nafta kalonte në brazda si tē arave. Menjëherë filluan pregatitjet për mbylljen e pusit me gjithëse akoma nuk ish vendosur mënyra e mbylljes. Për këtë qëllim u formuan dy brigada speciale tē udhëhe-qura nga mjeshtrit Qemal Mahmuti e Sali Alushi.

Në kombinat filluan tē vinin qindra letra me propozime tē ndryshme se si duhej vepruar për zénien e pusit. Por në shumicën e këtyre propozimeve nuk merrej para-sysht fuqia kolosale e presionit tē pusit. U llogarit që në qoftë se në buzën e sylinës tē ngjeshur në tokë prej nga delte nafta nën shtytjen e fuqishme tē gazit, do tē vinje një hekur tē trashë sa dora, presioni kishte borç t'a priste si brisku perin e hollë.

Gryka e pusit vazhdonte buçimën. Nuk u pa ndonjë rast që tē zvogëlohej qoftë presioni, qoftë dhe zhurma e e tij. Pa mjete mbrojtëse ishte e pamundur t'i afrohej njeri.

Nafta vazhdonte tē ngjitej lart e pastaj tē shpërnda-hej si çurkat e shiut. Gropat e shumta nëpër fushë u mbushën plot dhe për ditë numuri i tyre shtohej. Të dukej sikur në fushën e Marinzës po formohej një liqen nafte,

bojë kafe të errët. Nga larg, nga rruga Lushnjë-Fier një-rëzit shikonin një tym të murmë që shkonte andej nga e shtynte era. Ay nuk qe tym, por gazi i dëndur që dilte me vrull nga gryka e pusit dhe pastaj tretej lart në hapësirë. Kush e mori vesh këtë ngjarje, pyeste: Si do të zihet?

* * *

Vullneti thyen edhe shkëmbin. Vendosmërija mposht vështirësitë. Guximi e trimërija shpartallon armikun. Armët e hekurta të ushtrisë i japid grushte dërmuese kundër-shtarit. Traktori çan sipërfaqe të mëdha tokash. Mina apo dinamiti sheshon edhe male. Po kundër pusit 542, më ç'farë armë do të lëftohej? Asnjë prej këtyre nuk ia arrinte. qëllimit. Atëhere si duhej vepruar? Cila do të ishte ajo forcë që do të mposhte egërsinë e pusit? A gjendej një forcë e tillë?

Në bazë të eksperiencës së naftëtarëve sovjetikë, vendos që zënia e pusit të bëhej me anën e preventorit, armaturë e çelniktë prej afro tre tonësh. Veprimet do t'i drejtonte kryeingjinieri sovjetik Gelgafa.

Tani dilte problemi, se kush do t'a conte preventorin deri në grykën e pusit. Në afërsitë e tij nuk mund të afrohej asnjë lloj motori i ndezur. Një shkëndijë e vogël qoftë e dalë edhe nga përpjekja e dy metaleve, brenda një të dhjete të sekondës, mund të shkaktonte një zjarr të llah-tarshëm.

U vendos, që preventori të çohej në grykën e pusit me ndihmën e arganellave, rrota me tel çeliku. Mbi to, do të vihej preventori dhe drejtimi i tyre të bëhej nga një njeri që do të qëndronte pranë pusit. Por, ishte shumë e vështirë të komandonje arganellat. Mjeti për shtytjen e tyre qëndronte larg pusit, më se 200 metro. Ky mjet drejtohej nga njerës të cilët do tu jepnin drejtimin e arganelave në bazë të komandës që merrte nga ai që ish pranë pusit. E gjithë puna qëndronte në zotësinë e atij që komandonte.

Kryeinxinjeri Gelgaft nuk donte tē kish njeri pranë, nuk donte tē rrezikonte edhe jetën e tē tjerëve. Poç prapa shpinës së tij ishin bërë preqatitjet e duhura pér çdo tē papritur. Bashkëpuntorët e tij tē porsa ardhur nga Bashkimi Sovjetik, Stepani, Pjotri, Maksimi, Aleksej, tē gjithë inxhinjerë dhe specialistë tē sprovuar tē naftës, nuk rinin shumë larg kryeinxinjerit. Bashkë me ta ishte dhe një grup specialistësh, inxhinjerësh dhe drejtonjësish tē kombinatit tē naftës. Tē gjithë ishin nën mbrojtjen e zjarrfiksavet që i lagnin vazhdimisht me pompat e ujtit.

Kryeinxinjeri sovjetik hip i nje leth dhe ngriti flamurkat lart. Me këtë veprim ay dha sinjalin pér lëvizjen e arganellavet. Ato filluan tē lëvizin me ngadalë si ndonjë breshkë e plagosur...

... Po brigada e rinisë «Miqësia» ku gjëndesh? Vëndin e saj tani e kish zënë një brigadë tjetër «eterogjene» me inxhinierë, specialistë, drejtonjës tē ndërmarrjes, tē aftë pér tē kontribuar në zënien e pusit. Kish edhe një pjesë tē mirë nga tē rinjtë e brigadës që qëndronin tē gatëshëm pér tē marrë urdhëra tē ndryshme. Ndërsa një pjesë tjetër ndodhej në faqe tē kodrës në jugë-lindje tē pusit e prej atje priste me vëmëndje dhe me zemër në dorë ngjarjet e mëvonëshme.

Çdo tē ngjasë vallë? A thua i ardhì fundi?

... Përbrënda katër këmbëve tē sondës diçka têrhoqi vëmëndjen e tē gjithëve. Preventori po i afrohej nga lart grykës së pusit. Posa u afrua në buzë, preventori u droth. Nafta dhe gazi pér disa sekonda filluan tē përhapen me furri. Curilat e naftës, gazi i fuqishëm dhe plot helm, rrëzuan pér tokë kryeinxinierin Gelgaft.

— Ç'dreq tē kish ngjarë? Mos vallë pusi nuk pranon frerin e çelniktë? Naftëtarëve u hip i gjaku në kokë.

— Po kryeinxinieri ç'u bë? — pyeti i habitur një tjetër. Antarët e brigadës që prisnin me pa durim çastin gazmor pér zënien e pusit — zgurdulluan sytë tërë ankth.

Sikur tē kishin lejë e tē derdheshin tē gjithë si një trup në ndihmë tē kryeinixhinierit ...

Po ja, ata shumë shpejt sikur u qetësan. Tre a katër veta nga tē brigadës speciale e marrin me tē shpejtë kryeinixhinierin dhe rrëmbimthi derdhen për në infermieri. Flamurkat e komandimit tā arganellave i rrëmben kryeinixhinieri i kombinatit shoku Rexhep Reka.

Po në këto çaste, posa përsëri preventori i afrohet buzës së grykës, një vërshim dolli nga gryka anash. Disa metro pranë grykës u gjend drejtori i përgjithshëm i kombinatit, shoku Ramiz Xhabia. Ay bije për tokë pa ndjenja. Rexhepi me t'a parë, le flamurkat, derdhet me tē shpejtë në ndihmë tē tij dhe e largon nga rreziku. Po flamurkat e komandimit tē arganellave? Ja një tjetër flamurtar i mori ato në dorë dhe vazhdoi komandimin. Ishte specialisti sovjetik Stepan Kaledari, një burrë i fuqishëm, shpatull gjérë e zeshkan.

Para syve tē njerëzve dilnin plot tē papritura. S'kishin kaluar shumë, nga infermierija del me shpejtësi një njeri, i cili vrapon në drejtim tē vendkomandës së arganellave. Ay i merr flamurkat Stepanit dhe vazhdon tē komandojë. Ishte kryeinixhinieri sovjetik Gelgafa, i cili kish ikur nga infermierija duke shkelur urdhërat e rrepta tē mjekut. Midis tyre ishte zhvilluar ky bisedim:

— Shoku kryeinixhinier, nuk duhet tē lëvizni — i pat thënë mjeku, po sa Gelgafati ishte përmëndur.

— Ju falënderoj për kujdesin dhe ndihmën t'uaj. Më është e pamundur tē qëndroj këtu. Jam i shtërtnguar tē mos iu bindem. Me dënoni më von ...

— Jo, nuk ju lejoj. Kam përgjegjësi për jetën t'uaj. Nuk ju lejoj në asnjë mënyrë — kish thirrur i nxehur dhe plot vendosmëri mjeku.

— Për më gjatë nuk premton koha. Të lutem më falni për mosmirësjelljen ...

Mjeku thirri e bërtiti, por pa sukses. Gelgafati u zhduk

në drejtim të pusit, në mes të vërshimeve të fuqishme të naftës dhe gazit, në mes asaj zhurme që të trullos, . . .

Puna vazhdonte. Pusi gjithënje dukej më i egër. Posz preventori i afrohej buzës së tij, pusi ulurinte me të madhe. Gjëndja e njerëzve sa vinte bëhej më e keqe. Ata i mbante më këmbë vetëm fuqija e vullnetit dhe vendosmërisë, fuqia e dëshirave për të parë me sytë e tyre fitoren. Zjarrfikësit, pa pushim godisnin me pompa uji njerëzit, preventorin dhe arganellat. . .

... Mjeshtri Qemal Mahmuti, qëndronte si ata ushtarët e frontit që presin urdhër për t'u hedhur në sulm. Ay ndodhej fare pranë pusit. Duronte torturën e fortë që shkaktohej nga zhurma e madhe, nga gazi helmatonjës, tiga vërshimet e herë pas herëshme të pusit. Me ata sytë e tij të svogëluar dhe gjysmë të hapur, mjeshtri mundohej të shikonte skenën që zhvillohej në grykën e pusit. Preventori po i afrohej përsëri. E kjo ishte ndoshta e dhjeta herë. Sipas komandës, arganellat e lëshuan, më me forcë preventorin mbi pus. E ja egërsisë së tij po i vinte fundi. Ay sakaqë do të vulosej. Qemali u ngrit më këmbë dhe u bë gati të thërriste me sa fuqi që kish «Urra! Fitore! Urraaa!» Por vërshimi i naftës dhe gazit anash, sikundër dhe herët e tjera, e detyroi që për një çast të mbyllte sytë. Kur i hapi i dolli përpara një e papritur e llahtarshme. Toka u droth. Pusi gjëmoi, hodhi përtej preventorin dhe ..

PËRBINDËSHI I ZJARRTË SHPËRTHEU NË QIELL

Nga fërkimi i metaleve u bë e pamundur të zhdukej ajo shkëndijë e vogël, ajo xixë që shkaktoi atë zjarr të madh. Dukej sikur gjuhët e flakës kërkoni të përpinin qiillin e kaltërt. Një valë e nxehtë ajri u përplas mbi njerëzit. Toka e lagur me naftë filloi të thithë flakën dhe zjarri menjëherë përhapej. Një tym i zi sterrë po mbësh-



Flaka që shpërtheu në grykën e pusit eruptiv Nr. 542.

tillte gjithçka rrreth e përqark pusit. Nxehtësi prej mijra gradësh, flaka e tmerrshme, tymi i dëndur, i bëri njerëzit ta quanin vehten të humbur. Sejcilit i dukej sikur nga çasti në çast do t'a rrëmbente vdekja e sigurtë.

...Kapteri zjarrfikës Haki Miraka, që nuk ishte shumë larg pusit, pa parë se çpo ngjiste rrreth e përqark, pa menduar se shumë shpejt do të bëhej shkrumb e hi, derdhet kundër flakës. Po pse vallë? Mos lojti mënç? Tymi i dëndur ia veshi sytë. Ay mbajti mend vetëm drejtimin ku duhej të kalonte dhe eci me shpejtësi. Po ku vinte vallë zjarrfikësi? Mos deshte të shuanте zjarrin me duar? Jo. Ay shkonte në ndihmë të dikujt. Për disa çaste u vërtit nëpër tymin e flakën, sikur të kërkonte rrugën që kish nisur...

«Ku të jetë vallë?» Kapterin e pushtoi shqetësimi përfatim e kryeinxhinierit. Shpejtoi hapat. Ndjeu se mezi merrte frymë. Sytë iu veshën dhe i vinte të përzjerë. «Ku të jetë vallë?» Përsëriti dhe një herë kapteri. Dhe ja, para tij dalin dy njerës të shtrirë pa ndjenja. Siç dukej një tjetër kish shkuar më përpara në ndihmë të Gelgafit. Pranë tij dergjej kapteri zjarrfikës, Mustehan Sela, i pafuqishëm përf të ndihmuar në shpëtimin e kryeinxhinierit. Të dyve iu kishin marrë zjarr robet. Haku përf disa çaste shtangu në vënd. Ç'të bënte tanë? Si mund t'i shpëtonte të dy menjëherë? Po ja me çapa të shpejta drejt tij po vinte major Thanasi. Kapteri mori më shumë kurajo dhe e ndjeu vreten më të fortë. Së bashku me majorin e ngritën Gelgafit i grisën mushamanë mbrojtëse që i kish marrë zjarr. Dhe major Thanasi mori në krahë Mustehakun...

Në ndihmë të kryeinxhinierit sovjetik kishte shkuar edhe radisti i ri i aviacionit Neki Kaçaniku. Kur plasi flaka ay gjëndej pranë pusit. Kur pa se kryeinxhinieri kishte rënë pa ndjenja, djaloshi shpejtoi në drejtim të tij. Iu përcëllua fytyra, duart dhe robat i kishin marë flakë. I dukej sikur nga balli po i rrithët djersë. Por ay në ato,

çaste nuk e perceptonte dot, në se ishte djersë apo copka të vogla të lëkurës së djegur që i rrëshqisin nga balli. Djaloshi menjëherë u qetësua, posa pa shokë të tjerë që muarën kryeinxhinierin. Në çast ay u përplas në tokë pa ndjenja. Flaka e mbuloi. Ashtu si për të tjerët pati dhe për 'të shpëtimtarë...

Kryeinxhinieri i kombinatit Rexhep Reka e përblo-dhi vehten shpejt. Ay u derdh midis tymit e flakës. Ku shkonte? Mos vallë rruga e shpëtimit ish andej?

— Largohuni, largohuni! — thërriste Rexhepi. Po kush e dëgjonte? Nëpër tymin e zi sterrë, nëpërmes gjuhëve të flakës që dridheshin rrëth e rrötull pusit, ay dallonte njerës që vraponin. Sa të çuditshëm janë këta njerës?! — thoshte me vehte kryeinxhinieri i kombinatit kur pa të lëshoheshin si shigjeta, Kadri Hoxha, Demir Kasëmi, Sami Qerimi e kush'edi kush tjetër. Si nuk e shikonin vehten që po digjeshin, që trupi i tyre kish marrë flakë?

Mjeshtri Qemal Mahmuti, kish rënë për tokë porsa plasi flaka. Kish menduar të qëndronte ashtu përbys sa të mbledhët vehten, mirpo kur pa se një valë e nxehëtë e mbyti në djersë dhe filloj t'i zihej fryma, u cuaj përnjëherësh. Sytë iu veshën. I mbajti për pak mbyllur. S'dinte ç'të bënte. Dëgjoi ca zëra të mbytura që thërrisin «shpejt, shpejt» Po gjë nuk kuptonte. Mushamaja i mori flakë.

Kur e mblohdhi vehten dhe e kuptoi se ku ndodhej, u përpinq të shuanë zjarrin në mushamanë e tij dhe vrapi midis flakës Diku u pengua dhe ra përbys. U ngrit përsëri dhe pa t'i dalë përpara Kamber Bezhani.

— Eja të largohemi shpejt, shoku brigadier — i thittri Kamberi.

— Po shokët?

— U tërhoqën!...

Sejçili, me t'i kthyer shpinën pusit, ngadalësonte hapat. Në krahë ose në shpinë mbante një njeri që s'mund të ecte.

...Rexhepi mezi i hidhte çapat. I dukej sikur nga çastë në çast do të gjunjëzohej. Do të binte e kurrë nuk do të ngrihej dot. Kish marë një naftëtar të djegur keq. Për një çast u ul, si të çlodhej e të përmblidhë forcat. Kur pa se mushamaja vazhdonte t'i digjej, kur dëgjoi rënkimet e të plagosurit që mbante në shpinë, u ngrit me të shpejtë.

...Zjarri përhapej me shpejtësi. Dukej sikur digjej e gjithë toka në periferinë e pusit. Tymi i zi sterrë mbuloi edhe maqinat e zjarrfiksavet.. Pas tij sulmonte edhe flaka, e maqinat do të digjeshin.

— Të shpëtojmë maqinat! - thirri dikush. A thua këto fjalë ishin kushtrim mësymjeje për detashmentin e vogël të shoferëve?

Oficer Lolo Alla, shpejtoi me vrap në drejtim të maqinavet. Pas tij edhe Musa Doraci, Bari Cuni, Kamber Kafexhiu e Pandi Koka. Ata dukeshin sikur ishin në garë për vrapime, jo në pistën e ndonjë stadiumi, por midis tymit verbonjës, midis flakës që rezikonte jetën e tyre. Sejcili komandoi vehten. Maqinat filluan të ndizen. Zhurma e tyre pothuaj nuk dëgjohej fare. Po nga do të largoheshin? Gjithçka ishte mbuluar nga tymi i dëndur. Asnjëti s'mund të kuptonte se nga ishte lindja dhe nga perendimi. Ish rrezik edhe se mos përplaseshin maqinë me maqinë. Sejcili vendosi t'i jepte mbrapsht maqinës së vet. Kjo do të ishte e vëtmja rrugë për t'ju larguar rrezikut, i vëmvi orientim. Maqinat lëvizën mbrapsht pa ditur se ku shkonin. Dy maqinat e para morën flakë, kurse të tjera rat shoferat i larguan. Selua me Kamberin posa lanë maqinat, u derdhën për të shpëtuar ato që po digjeshin. Po u kthyen mbrapsht. Ato kishin marrë flakë në të gjitha anët. Çdo përpjekje ishte e kotë.

...Zjarri e tymi i pusit dukesh ngado. Drita e tij, ndriçonte majat e Tomorit e të Nemërçkës, fusha e madhe e Myzeqesë edhe natën, shkëlqente si ditën. Fshatarë e kooperativistë rrëmbyen veglat e punës dhe u derdhën

drejt pusit 542. Qindra njerës nga fshatrat për rrëth u nisën drejt tymit dhe zjarrit.

— O burrani të shuajmë zjarrin!

Naftëtarët e qytetit «Stalin» me shpejtësi ua hipën maqinave dhe u nisën drejt pusit. Nënat dhe motrat e tyre që parandjenin rrezikun, që u kanosej të afërmëve, i përcuall me sy të përlotur, me dorë në zemër dhe ndonjë edhe duke iu lutur Zotit për t'i ruajtur nga fatkeqësitet. Ato qëndronin në portat e shtëpive dhe nuk bënin zë. Askujt nuk i shkoi mëndja t'i ndalonte...

Turmat e njerëzve s'kishin mbarim. Ata kërkonin t'i derdheshin pusit dhe t'a shuanin, të shpëtonin naftën e tyre. Por kjo ishte e vështirë. Turma e popullit ishte e pa-fuqishme përpëra forcës së zjarrit, përpëra atij përbindëshi të zjarrtë. Një forcë e tillë përvëlonjëse treste jo vetëm njerëzit por edhe tonelata hekur. Kur muarën vesh një gjë të tillë, njerëzit filluan të pyesin:

— Po si do t'i bëhet atëherë? A do të shuhet ndonjëherë pusi? A do të vazhdojë shumë kohë të digjet nafta jonë?

— Të izollojmë zjarrin!

Dhe puna filloi. Skuadrat e naftëtarëve të përforcuara me banorët e periferive të Patosit u përhapën në të katër anët e pusit. Me kazma e lopata, nën forcën e madhe të nxehësisë, rrëth e përqark pusit u hapën hendeqe për izollimin e zjarrit. Rreziku i pëhapjes më shumë të tij u zhduk. Por, detyra s'kish mbaruar...

Të nesërmen specialisti sovjetik Stepan Kaleda së bashku me mjeshtërit Sali Alushi dhe Qemal Mahmuti duallë përtej kodrave drejt pusit. Të veshur me roba speciale shkuan deri në hendeqet e çelur.

— Kryesorja është që të shuhet zjarri i përhapur, të izolohet ay deri tek pusi dhe kjo do të japë dorë për t'a shuar, - tha Stepani. Edhe tek ne ka ngjarë të shpërthejnë zjarre të tillë. Sepse puset eruptive po të jetë se nuk tre-

nohen qysh në' fillim, eshtë shumë e vështirë t'i mënjanosh nga zjarri. Nuk mund të evitosh fërkimin e metaleve që pa tjetër nxjerrin shkëndija zjarri.

Njerëzit nga të katër anët e atdheut, të shqetësuar pyesnin për fatin e pusit. A do të shuhet? Si mund të shuhet më shpejt?

Në kombinatin e naftës «Stalin» dhe në ministrinë e industri-minjeravet filluan të vijnë qindra propozime dhe mendime të ndryshme. Ndonjëri mori mundimin dhe shkoi deri në Patos, për të çfaqur mendimin e tij me gojë. Në disa letra të ardhura nga barinjtë e Gramozit dhe të Nemerçkës, propozohet që mbi pus të viheshin disa thasë me lesh e mbi 'to ndonjëzet guna të dhirta e pusit do të shuhej me siguri. Disa propozonin që mbi grykën e pusit të vihej një tank ose një top i rumbullakët prej plumbi disa dhjetra ton i rëndë. Besimtarët propozonin që të bëheshe një meshë në të gjitha kishat e vendit e t'i luteshin zotit për të na shpëtuar naftën. Në letra thuhej që pusit të bombardohej me aeroplanë. Kish pastaj dhe shumë propozime për metoda të ndryshme shuarje me anën e rrëres e ujit. Por, po thuaj të gjitha propozimet nuk merrnin parasysh forcën e pusit dhe të zjarrit. Nuk merrej parasysh se në grykën e pusit kishte treth 3000 gradë nxeh-tësi....

Heroizmi çfaqet në ata njerëz që e njohin terezikun; e kuptojnë se po ecin drejt vdekjes, e ndjejnë se ndoshta po jetojnë minutat e fundit në jetën e tyre, e me gjithë atë të frymëzuar nga ndjenja fisnike njerëzore, ecin përpara me guxim dhe me mendje të kthjelltë për t'ja arritur qëllimit..

E vërteta eshtë se n'ato çaste përpara se trimat të niseshin për tu futur në mes të flakëve, të gjithë i kish pushtuar një ndjenjë e fortë emocioni. Nga dritoret, nga dera, nga të gjitha anët e zyrës së sekretarit të komitetit të partiёs të kombinatit të naftës hynte fëshkëllima e tër-

buar e pusit, si pér tē dëshmuar fuqinë kërcënonjëse tē flakës e tē zjarrit përvëlonjës. Në fytyrat e tē gjithëve pasqyrohej kjartë një sforcim dhe lodhje e madhe fizike e njëkohësisht një vendosmëri dhe gjallëri e mahnitëshme shpirtërore.

Sekretari i komitetit tē partisë u hodhi tē gjithëve një vështrim mirënlohës, që tē mbushte me guxim, një vështrim tē tillë shprehës që mund tē lindë vetëm në situata tē tilla, një vështrim para tē cilit edhe fjala më e fuqishme është e varfër. Kërkuj nuk i rrihej në një vënd.

— Atëhere shokë, foli i tronditur sekretari i partisë, para se tē niseni do tē leni dokumentat e partisë dhe tē rinisë.

Këtë e dinin tē gjithë, prandaj kishin ardhur. Komunistat Haki Gjondedaj, Mendu Backa, Qemal Mahmuti, tē rinjtë Ilia Minella, Bilal Ruka e tē tjerë, filluan nga dalë, tē nxjerrin dokumentat. Nuk është aq lehtë tē ndar hesh nga ajo teser e kuqe, e vockël: ajo është shumë e shtrenjtë, ajo është simbol i dinjitetit, i nderit i ëndërrave tē atij që e mban, ajo tē bën tē ndiesh vehëten tē sigurtë e kryelartë sepse është dëshmi e kjartë se ti je fisnik, je komunist, se i shërben me devocion atdheut.

Duke lënë me radhë, mbi tavolinë dokumentat, ata e ndjenin thellë në shpirtë, se me aktin që po gatiteshin tē bënin, me gjithë se po largoheshin prej tyre ato po bë heshin më tē denjë pér tē mbajtur teseren e antarit tē partisë dhe teseren e antarit tē Bashkimit tē rinisë.

Ata vështruan pér herë tē fundit dokumentat, e pasi shternguan burrërisht duart e shokëve që ndodheshin në dhomë, dolën tē vendosur . . .

* * *

Me kërkësen e Qeverisë së Republikës Popullore tē Shqipërisë, Qeveria e Bashkimit Sovjetik dërgoi urgjentësisht në vendin tonë zjarrfikësin e shquar kolonelin

Po kush mund t'i hiqte gjith ato hekura?

Larg pusit kishin ardhur traktorë dhe buldozëtë. Këta do të tërhiqnin hekurishtat. Po motorët e ndezur nuk mund të afroheshin shumë, sepse shkaktonin zjarr në periferitë e pusit dhe hapej punë e re. Veç kësaj a kishte fuq motori të punonte normalisht në kushtet e një nxeh-tësije të madhe? Plot probleme dhe vështirësi delnin përpara naftëtarëve.

Më kryesorja ishte lidhja e hekurave në kavo që të mund t'i tërhiqnin traktoret. Po a mund të afrohej njeri deri aty? Deri në 50 metro nxeh-tësija të shkrinte si qirifin. Atëhere si do t'i bëhej? A mund të ndërprijet sulmi i naftëtarëve dhe zjarrfikësave kundër pusit? A do të gjendeshin njerës kaq të guximshëm, sa me kokë në torbë të hynin midis asaj nxeh-tësije, të shihnin vdekjen me sytë e tyre?

Po, kish. Dhe këta ishin naftëtarët.

— «Vullnetarë!» — Kjo fjalë u hap vetëtimthi.

Ishte mbrëmje. Drita e pusit ndriçonte sikur të ish mezi i ditës. Një grumbull naftëtarësh u mbloth aty pranë menxës. A thua të gjithë këta ishin vullnetarë?

— Para se të vendosni, shokë — tha sekretari i komitetit të Partisë Jorgji Shuli, duhet të mendoni mirë. Gjëndja e krijuar në pus, është mjaft e rrezikëshme. Asnjëri nuk është i detyruar të shkojë, duke ditur se po shkon drejt vdekjes. Në këtë mes nuk ka urdhëra. Ay që shkon atje ka përpara vdekjen, sepse do t'i afroheni dhe dy metro pranë grykës së pusit. Dhe rreziku ndodhet gjithmonë pranë... Po ndryshe nuk ka se si të veprohet. Pa largimin e hekuravet është e pamundur shuarja dhe zënia e pusit... Tani kush e do fjalën?

— Shkruamëni mua — foli i pari Qemal Mahmuti.

— Edhe mua — më quajnë Hekuran Hyseni, E njeri pas tjetrit duallën pothuajse të gjithë, Koli Nurja, Dine Leshani, Ilija Mënella, Qazim Shehu, Muharrem

Muho, Bilal Ruka, Kamber Brahimi, Xhevair Plaku e të tjerë.

... Vullnetarët sikur të ishin ushtarë rekrutë zënë radhën për t'u vizituar tek mjeku. Po doktori ishte i mërzitëshëm. I mbante nga një sahat në vizitë, i kontrollonte imbarë e prapë, por më tepër shikonte funksionin e zemrës...

— Po pse nuk hyn, mor shok — bërtiti i nxehur doktori. Ilija nuk e kuptoi pse i çfryu ashtu.

— Juve thatë, një nga një shoku doktor. Unë presa të dalë shoku që hyri para meje. Juve kërkonit rregull dhe po u qëndrojmë dy orë e ca në rregull...

— Hajde, hajde, hyrë shpejt, se ay që është brenda është kokë gdhe, s'mer vesh e s'më kupton. Don t'i shkojë e tija...

Ilija nuk kuptoi gjë. Hyri brenda dhe u çvesh. Kur vari robet pa aty në një stol të ulur Xhevair Plakun, një djalosh i ri që qëndronte gjysmë i xhveshur dhe meazallah se luante nga vëndi.

— Mos je gjë sëmurë? — pyeti pa të keq Ilija.

— Jo mor vëlla, unë jam fare mirë, po ec e mbushja mëndjen doktorit. Unë t'a dinja vehten keq nuk do të zotohesha në organizatën e rinisë, bile nuk do të dilnja as vullnetar.

— More djalë, të thash, ti nuk je në rregull, trupi yt nuk mund të qëndrojë asnjë minutë afër pusit...

— Më duket se ma bën për inat. Po unë s'të kam rënë asnjëherë në dorë mor shoku doktor, pse tani më nxjer hyçka?

— E po s'kam ç'të bëj, mor djalë. Më lerë të qetë tani se edhe unë kam hallet e mijë, përgjigjem për shëndetin t'uaj dhe...

— Unë nuk iki prej këtej po s'më lejove. Pastaj pse më ndalon? Në qoftë se vdes, vdes unë dhe jo ti. Ju lutem doktor, më lejo...

dhe vijoi: — Jo, të shkojmë bashkë, për më lehtë të marrim dhe Hakiun.

— Unë nuk ju lejoj më juve, shoku Tkaçenko — tha Qemali sikur të ish eprori i tij. Tkaçenkoja vuri buzën në gaz. Pa pandehur derdhet përpara me vrap. Pas disa hapash të shpejta, me forcat e krahëve të tij, kap Bilalin dhe Ilijan dhe i tërheq me shpejtësi të madhe.

— Kush ju tha të shkonit atje? Pse thyeni urdhërat? — bërtiti Qemali.

— Shoku brigadier, po, po u lidh kavoja në ato dy këmbët e skelës çdo punë merr fund menjëherë. Apo nuk është kështu? Ne vendosëm vetë t'a bënim atë, dhe...

Për atë punë që po diskutonte Qemali me Tkaçenkon, të dy pjesëtarët e brigadës së rinisë deshin t'a kryein vetë, pa marrë parasysh se çfarë rrreziku i kanoste.

— Juve nuk ju lejoj, bërtiti Qemali. Dhe pa humbur kohë thirri Kamber Brahimin dhe Muharrem Muhon...

— Kjo është e pamundur — bërtiti Tkaçenkoja dhe u mvrejt në fytyrë, se e kuptoi që Qemali i thirri të dy naftëtarët për të shkuar bashkë me 'ta në vendin ku thosh Tkaçenkoja.

— A nuk do të jetë më mirë të na tregoni se si duhet të veprojmë dhe të shkojmë jo dy po katër veta?

— Jo, — tha i vendosur zjarrfikësi sovjetik.

Mjeshtri nuk dinte ç'të bënte. Përpara tij ishte një pengesë që s'gjente dot mënyrën për t'a kaluar. Puna duhesh bërë, po ashtu siç thosh Tkaçenkoja atij nuk i dukeshe më vend.

— Nisemi, — tha Tkaçenkoja.

Qemali bëri pak më të djathëtë, i tha Hakiut se çdo të bëhej dhe ashtu me gjysmë zemre u nis bashkë me shokët. Hakiu pasi u dha urdhërat e duhura zjarrfikësavet, niset bashkë me 'ta.

Tkaçenkoja ecte përpara sikur të ishte edhe ushtar edhe komandant. Të nxehtit e math e avullonte në çast

ujin. Mushamatë e tyre thaheshin brenda edhe disa sekondë davet. Uji avullonte me shpejtësi të madhe. Mijrà gradë nxehëtësi kishte pëprpara tyre. Ja, për një sekondë të pestë do të digjeshin si kashta në zjarr. Pori para syve të tyre s'dukej as vdekja as tmeri i saj, para tyre qëndronin vëtëm këmbët e skelës, mbi të cilën kishte disa dhjetra ton hekur që duheshin të pastroheshin nga pusi.

Dy veta në njerën këmbë e dy në tjetrën lidhën kavot. Qemali ngriti dorën dhe traktorët e lidhur njeri pas tjetër për të bashkuar fuqinë e tyre tëfheqëse, heqin zvare skelen...

Pas 12 orësh punë të pa ndërprerë, brigada speciale e mjeshtrit Qemal Mahmuti, largohet nga pusi. Të gjithë e ndjenin vehten të këputur. U vinte të përzjerë, posa u gjenden në ajr të pastër. Disave u ra dhe të fikët.

Pas disa orësh pushim. Tkaçenkoja dolli nga baraka. Shtriu krahët, bëri disa lëvizje gjimnastikore dhe u vesh me rroba speciale. Ndërkohë i del përpara mjeshtri i çipi-pim Sali Alushi, i cili do të udhëhiqte brigadën e dytë speciale.

— Nisemi, shoku Alush? — i tha Tkaçenkoja në gjuhën e tij. — Më duket se edhe pak punë kemi. Pastri-tat të pusit i ka ardhur fundi. Po a u vizituat tek mjeku?

— Sigurisht, ndryshe s'na lejojnë të shkojmë në pus, — gjegji Saliu me atë zënë e tij të fortë. Saliu është një naftëtar i regjur, i guximshëm dhe me vullnet. Bën pjesë në gardën e vjetër të naftëtarëvet që u rritën gjatë vjetëve të çlirimt. Ka një shpirt të kalitur me vështirësitë. Njeri i pa përtuar dhe i gatshëm për çdo gjë...

Pasi zjarrfikësit kishin zënë pozicionet e duhura, brigada e Sali Alushit, u vargos tatëpjetë në drejtim të pusit. Përpara printe Tkaçenkoja, Saliu dhe major Hakiu. Pranë pusit Saliu ndau forcat sipas këshillave të Tkaçenkos. Së bashku me atë, mjeshtri bënte zbulimin, ashtu si kish vepruar dhe Qemali. Saliu ka si cilësi që kur është puna

delikate ose e rrezikëshme, preferon t'a kryejë vetë dhe t'i mësojë naftëtarët se si duhet vepruar. E kështu i ngjau që në rastin e parë.

Një grumbull hekurishtash, nën goditjen e vazhdushme të pompave të ujit kishn humbur ngjyrën e kuqe dhe tani mund të lidheshin me kavo. Bashkë me tre naftëtarë Saliu niset. Hekurishtet ndodheshin larg pusit vetëm disa metro. Të nxehtit ishte i padurushëm. Aty ishte shkrirë hekuri dhe jo trupi i njeriut. Së bashku me 'ta me shpejtësi e guxim, kavoja u lidh dhe para syve të tyre traktori e tërroi. Naftëtarët të rëmbyer nga gjëzimi se po i dilnin në krye detyrës, harronin torturën që kishin hequr gjatë lidhjes së kavos dhe vunë buzën në gaz kur panë, që hekurishtet po tërhiqeshin zvarrë dhe po largoheshin nga pusi.

Por ndodhi diçka e pa pritur. Kundër brigadës speciale të Salit Alushit dhe zjarrfiksave nxehësija shpërndahet më me furi. Një erë e fortë filloj të fryjë nga jugu dhe naftëtarët e zjarrfikësit nisi t'i përshkojë një nxehësi aqë e madhe sa sikur të ishin afër grykës. Rreziku se brigada së bashku me detashmentin e zjarrfiksave do të përvëlohet, sa vinte bëhet më i madh. Tkaçenkoja e kuptoi menjëherë këtë rrezik dhe urdhëoi tërheqjen sa të ish e mundur më shpejt.

— S'kemi mbaruar akoma pastrimin, shoku Tkaçenko,
— thirri Saliu.

— Tërhiquni shpejt, — urdhëroi zjarrfikësi sovjetik.

Posa brigada u largua nga rajoni që përshkonte nxehësija, Hakiu mori masa për largimin edhe të zjarrfiksave. Por për këta tërheqja ishte më e vështirë. Zjarrfikësit vettë pa pompat mund të largoheshin shumë shpejt, por rrezikoheshin të digjeshin linjat e pompave të ujit.

Me shpejtësi pranë zjarrfiksave vjen kolonel Gjoni. Ay, pa parë vehten e pambrojtur, rrëmbeu një pompë dhe filloj të godasë me ujë zjarrfikësit me radhë që tërhiqnin

linjat. Lufta me nxehësinë e madhe për ruajtjen e linjave të pompave vazhdoi më se një orë.

Dhe kur era u pre, brigada, me në krye Tkaçenkon, u kthye nga pusi. Lajmi se gjithshka në pus ishte pastruar, u përhap me shpejtësi në të katër anët. Shpresa se nafta do t'u kthehej depove po u buzëqeshte. Një ndjenjë krenarie dhe gëzimi pushtoi të gjithë naftëtarët. Përbindëshit të zjarrtë po i vinte fundi. Dora e fuqishme e Tkaçenkos dhe e trimave të tjerë po e mposhte. Rezistenca e tij po thyhej. Tani ç'duhej bërë?

DËSHIRA, — SHQETËSIM, — GËZIM

Ditët e qershoret bëheshin gjithënë më të nxehëta. Dielli digje. Në mes dite ish vështirë të duronje rezet përvëlënëse të diellit. Por naftëtarët dhe zjarrfikësit, që si të thuash, u argasën në përlleshje me të nxehtit, s'para e ndjenin vapën e qershoret. Vapë të madhe ndjenë xhenerët e ushtërisë gjersa prej ditën arkën e dinamitit, prej disa kv., ata ishin bërë tërë djersë.

Nënkoloneli i ushtrisë popullore, xhenjeri Mendo Backa për orë të tëra kontrolloi arkën, përcaktoi normat e rezistencës së sipërfaqes së saj në kushtet e të nxehtit në grykën e pusit, dhe vendosi fijen elektrike në kapso llë, me te cilën do të shkaktohej shpërthimi i dinamitit. Llogaritjet i hëngrën shumë kohë. Duhej caktuar me saktesi koha e rezistencës, po pa mënjanuar se arka gjatë trugës deri tek pusi do të goditej edhe me pompat e ujtit. Por këto në asnjë mënyrë të mos lagnin dinamitin...

Arka me dinamit do të çohej në grykën e pusit, do të ngrihej nja dy tri metro më lart dhe aty me një shkëndijë elektrike do të shpërthente. Ky shpërthim do të shkaktonte një boshllék ajri dhe në çast do të shkëpuste flakën nga gryka e pusit. Kështu zjarti do të shuhej një

Sipas tregullores, ushtarakët u përgjigjën:

— I shërbejmë Republikës Popullore të Shqipërisë, . . . Ishte mesditë. Prapa kodrës në jugë lindje te pusit, atje ku nxehtesija e flakës ishte më e dobët, ishte një bunker. Aty u suall arka e dinamitit dhe u vendos mbi një vagon, i cili do të rëshqiste mbi shinat e shtrira deri afër grykës së pusit dhe atje nepermjet fijes elektrike do të shpërtonte. Por vështirësia ishte se paraqitej një rrezik shumë i math për shkak, se nga temperatura e lartë, dinamiti mund të shpërtonte para kohe dhe do të shkaktonte vrasjen e të gjithave. Kjo ishte arësyja që për këtë veprim duhej të kish vullnetarë.

Në brigadën e vullnetarëvet që udhëhiqej nga mjeshtri Qemal Mahmuti, bënin pjesë Qazim Shehu, Habib Pashaj, Zenel Arapi, Bilal Ruka e të tjerë. Naftëtarët, sipas urdherit të Tkaçenkos filluan të shtyjnë vagonin, ndërsa zjarrfikësit lëshuan pompat e ujit mbi njerëzit dhe arkën.

Tkaçenkoja, kolonel Banushi, kolonel Backa, major Hakiu, Thanasi dhe Martini, u shpërndanë sejcili sipas detyrave që kishin. Tkaçenkoja ecte përpara për të bërë zbulimin, për të përcaktuar forcën e nxehësisë dhe po të qe nevoja t'u thoshte zjarrfiksavet të shtonin edhe më te për goditjen me ujë të arkës. Major Hakiu së bashku me Aqifin ecnin në krah të Tkaçenkos dhe godisnin me pompat e ujit, nga përpara arkën e dinamitit. Kolonel Gjoni qëndronte midis zjarrfiksavet. Ay nuk ja ndante sytë Tkaçenkos, nga i cili merrte sinjale te ndryshme për drejtimin e pompare të ujit...

Nxehësija sa vinte shtohej. Së bashku me të shtohej dhe rreziku i shpërthimit te dinamitit. Nxehësija dhe afshi mbytës, avullonte në çast ujët dhe re avulli të qëndura ngjiteshin me shpejtësi lart. Vagoni rëshqiste gjithënë e më shpej drejt grykës së pusit. Vemendja e të gjithëve ishte përqëndruar tek arka e dinamitit. Ja, nga

ajo arkë varej jeta e gjith atyre njerëzve, varej fati i pusit.

Askush nuk mendonte për vehte. Vershimet e nxeh-tesisë tashti ishin çeshtje e dorës së dytë. Kryesorja ishte rezistenza e dinamitit. Dhe ja, gjer këtu çdo gje shkoi në rregull. Me anën e litareve metalike arka u ngrit lart dy metro mbi pus...

Tkaçenkoja urdhëroi që pompat e ujit të vendose-shin në tokë në mënyrë të tillë, që uji të godiste arkën dhe që të gjithë të largoheshin sa më parë. Urdhërat e tij vajtën në vend. Por ja pati dhe të tillë që nuk ju bindëن.

— Po ju, ç'prisni? Largohuni shpejt! — bërtiti me të madhe Tkaçenkoja.

— Shkonit ju përpara, shoku kolonel, — i thanë një zëri Hakiu me Aqifin. Fytyra e kolonelit mori një pamje nervoze. Por, në çast ay e kupto se dy zjarrfikësit nuk do të largoheshin pa u larguar ay vetë. Koha nuk priste...

Para se të mbrinin në bunker, zjarrfikësi sovjetik u tha:

— Nuk është mirë të mos bindeni. Ushtari është gjithmonë i bindur...

— Sho... — desh t'i përgjigjej Hakiu, po koloneli sovjetik u largua me të shpejtë në vendin ku ndodhej dinamoja që do të conte korrentin elektrik deri tek arka me dinamit e do të shkaktonte shpërthimin e tij.

Në këto çaste njerëzit ndjenin një gëzim përzjerë me shqetësim. Shpërthimi në kohën e duhur i dinamitit reali-zonte dëshirat e sejçilit. Po sikur të mos shpërthente në kohën e duhur? Po sikur litarët metalikë të këputeshin dhe arka të binte mbi pus? Çfarë do të ngjiste më tej? Si do të mbaronte kjo luftë?

Por besimi i madh të bën të harrosh fatkeqësitetë e mundëshme, të mbush me kurajo e guxim për të mposhtur-vështirësitë. Tanimë njerëzit kishin në dorë vetëm sustën

e dinamos, gjithçka tjetër varej nga mekanizmi, nga teli që do të çonte korrentin elektrik deri në arkën e dinamitit.

Mendu Backa shtypi sustën. Për një të dhjetën e sekondës, dinamiti duhej të shpërtihente. Të gjithë u bënë gati të pushtonin me gëzim njeri tjetrin, të bërtsnin me tërë forcën e tyre «Fitore».

Por jo, plasja po vonohej. Kjo i shqetësoi të gjithë. Sejcili shikonte mbi xhenjerin e dinamon. Kaluan disa sekonda. Dinamiti nuk plasi. Pusit i kanosej një rrezik i ri. Litarët do të këputeshin, dinamiti do të binte mbi grykë dhe pas shpërthimit aty do të çelej një gropë e madhe. Pusi do të shkatërrhej.

Xhenjeri që e njihet mirë profesionin e tij, i hodhi një shikim shqetësonjës Tkaçenkos, si t'i thosh: koha po kalon, rreziku është i afërt.

Ato ishin çaste tepër të rënda. Pusi ishte para rrezikut të shkatërrhej tanë në pragun e fitores. Pusi i popullit, nafta e popullit, për të cilën lëftuan me heroizmë të shquar heronjtë e pusit, vunë kokën në rrezik miqtë tanë sovjetikë, të humbiste ari i zi, për shpëtimin e të cilit naftëtarët po dergjeshin në shtratet e spitaleve dhe ashtu të sëmurë dhe me duar të rjepura, tresnin tërë mendimet tek pusi? A thua se egërsija e pusit, po triunfonte mbi heronjtë e naftës? A thua e përpjku përsëri naftën tonë?

Tkaçenkoja lëviste sa në një anë në tjetren. Në gjuhën e tij fliste me zë të ashpër. Disa herë përplasi grushtin tek muri i bunkerit.

Akoma nuk është mbushur minuta? Fytyra e tij shprehet zemërim. Ay tha:

— S'duhet humbur me kohë. Pusi është në rrezik. Rrugë tjetër veç tërheqjes së dinamitit **nuk ka...**

— Më lejoni të shkoj unë shoku kolonel Tkaçenko — tha Mendu Backa me një zë të vendosur dhe sytë e mëdhenj i shkëlqyen.

— Është rrezik! ... përsëriti ay.

— Më lejoni të shkojmë së bashku ndërhyri menjëherë major Hakiu me atë fytyrën të ndezur si flaka.

— Shkoni, shokë të dashur! — dhe që të dy i pushtoi, i puthi në buzë, sikur t'u jepte lamtumirën e fundit të dy trimave që shkonin drejt asaj rruge, që i ndante nga vdekja ndoshta vetëm një fije e hollë peri.

Hakiu me Mendunë ecnin me hapa të shpejta. Ata nuk shikonin më pusin. Nuk parandjenin asgjë të keqe dhe asgjë të mirë. Sytë e tyre të turbull qenë mbërthyer në një pikë të vetme: mbi arkën . . .

Hakiu u këput nga shoku dhe rrëmbeu pompën e ujit. Ndërkohë Menduj vete pranë dinamitit dhe mundohet të lidhë kavon.

— Hithmë ujë në duart se nuk më punojnë — thirri Menduj, — lere trupin . . . duart, vetëm duart . . . — Ti largonje ujin nga trupi, do të thosh të digjej. E Hakiu me shpejtësi të madhe e godiste edhe në trup edhe në duar, të paktën të mos vdiste nga djegia, por së bashku me të nga plasja e dinamitit.

Koha kalonte. Menduj edhe Hakiu për disa çaste harruan rrezikun e shpërthimit të dinamitit. Me të lidhur kavon, Menduj shpejtoi të liron te litarin metalik që arka e dinamitit të vendosej përsëri në vagon.

Sipas sinjalit që dha Hakiu, Tkaçenkoja me një grup vullnetarësh me sy të gjuar vrapon në drejtim të pusit. Fillon tërheqja e vagonit. Sa gjëzim ndjenë të gjithë kur dinamiti u largua nga gryk' e pusit!

Tkaçenkoja i pushtoi edhe një herë të dy heronjtë dhe tha:

— Faleminderit shokë të shtrenjtë, dhurata juaj është më e madhe se çdo gjë tjetër për jetën time . . . Kolonelit i shkëlqente fytyra nga një gjëzim i brendëshëm. Në çdo çast atij i kalonte një buzëqeshje e ëmbël gazmore nga sytë në buzë.



Naftëtarët kanë marrë në krahë kryeinxhinierin e shqar Sovjetik Nikollai Kristoforoviç, i cili mbylli pusin eruptiv Nr. 542.

Në një mëngjes të freskët, kur dielli lëshoi rrezet e tij të kuqërremta, brigada e rinsë «Miqësia me Bashkimin Sovjetik», u nis për të çelur një pus të ri. Fytyrat e të rinjve ndriçojnë. Në buzëqeshjen e sytë e tyre të gëzuar shkëlqen me tërë madhështinë e saj krenaria e naftëtarëve tonë, e atyre që në përlleshje me natyrën zbulojnë shtresa të reja nafte, që i japid atdheut arin e zi... .

SHËNIM

Në një përshkrim të tillë të shkurtër, in'u bë e pa mundur të përmëndnja të gjithë njerëzit që morën pjesë në çpim, në përlleshjen me pusin eruptiv 542 dhe zjarrin e madh.

Në shenjë mirënjohje të popullit ndaj heronjve dhe trimave të tjerë që u përleshen me pusin eruptiv 542, Presidiumi i Kuvendit popullor të R.P.SH. u akordoi urdhëra dhe medalje të ndryshme:

D E K R E T

për akordim dekoratash

Në mbështetje të nenit 58, pika 8, të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë,
Me propozimin e Ministrisë së Industrisë e Minierave,

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

D E K O R O N

I. ME URDHËRIN E PUNËS TË KLASIT I-rë

Kombinatin e naftës të Qytetit Stalin me këtë motivacion:

«Ka bërë një punë të shkëlqyeshme në çpimin e pusit dhe ka organizuar sistematikisht punimet gjeologjike për gjetjen e shtresave të reja naftëmbajtëse. Ka drejtuar dhe organizuar mirë gjithë punimet në shuarjen e zjarrit dhe mbylljen e erupzionit në pusin 542».

Sektorin zjarrfikës të Ministrisë punëve të bren-dëshme me këtë motivacion:

«Punonjësit e këtij sektori, kanë marrë pjesë në shuarjen e zjarrit dhe mbylljen me sukses të pusit nr. 542 me erupzion. Gjatë punës kanë treguar akte heroizmi pa kursyer edhe jetën, kanë organizuar në mënyrë të përsosur punën dhe kanë përdorur me sukses të plotë teknikën, duke kontribuar kështu përfundimin me sukses të kesaj vepre me rëndësi përfundimin me socializmit në vendin tonë».

Tkaçenko Konstantin Vladimirovi

Rakov Pjetër Petroviç

Mgeçan Korn Façaturoviç

me këtë motivacion:

«Gjatë punës për shuarjen e zjarrit në pusin me erupcion 542 janë dalluar në mënyrë të veçantë në organizimin e punës, duke punuar me guxim dhe heroizmë në kondita pune shumë të vështira. Kanë dhënë kontributin kryesor në shuarjen e zjarrit dhe mbylljen e pusit».

Xhafer Shaqir Spahiu
Ramis Alush Xhabija
Gjon Banush Osmani
Jorgji Ligor Shuli
Begjir Ali Amerika
Rexhep Hysni Reka
me këtë motivacion:

Polikron Mantho Cane
Sali Beljaz Alushi
Kamber Surja Brezhani
Pandeli Theodhor Duro
Muhamrem Vehip Muho
Haki Selim Miraka.

«Për organizimin e mirë dhe për kontributin e madh të dhënë në punimet e zhvilluara për shuarjen e zjarrit dhe mbylljen e erupcionit në pusin 542, për qëndrushmëtinë dhe abnegacionin e treguar në konditat e vështira pune përfundimin me sukses të kësaj vepre me rëndësi për ndërtimin e socializmit në vendin tonë».

Jashar Idris Shuku
Hysni Muhamrem Bakaj
me këtë motivacion:

Llazi Jorgji Berberi
Lolo Subi Alla

«Janë treguar të aftë në drejtimin e repartit në organizimin e shkëlqyer të punës dhe në përdorimin e përsosur të mjeteve teknike: Janë treguar të ndërgjegjëshëm dhe të guximshëm në shuarjen dhe mbylljen e pusit 542 me erupcion, vepër me rëndësi për ndërtimin e socializmit në vendin tonë».

II. ME URDHËRIN E PUNËS TË KLASIT II-të

Repartin nr. 507 të M.L.K.A. të Ministrisë së punëve të brendëshme, me këtë motivacion:

«Kanë marrë pjesë në shuarjen me sukses të pusit Nr. 542 me erupzion. Kanë punuar me guxim dhe trimëri pa kursyer edhe jetën, duke kontribuar kështu për përfundimin me sukses të kësaj vepre me rëndësi për ndërtimin e socializmit në vendin tonë».

Kaleda Stapan Ivanoviç Gorshenin Aleksej Ivanoviç
Dintinov Pjetër Petroviç Fufajev Maksim Jegoroviç
me këtë motivacion:

«Janë dalluar në mënyrë të veçantë për guxim dhe organizimin në punë, gjatë shuarjes së zjarirt dhe mbylljes së pusit me erupzion nr. 542».

Perikli Rapo Trebicka Llukan Theodhor Duro
Piro Taqo Bozgo Dhoskë Kristo Tundo
Eqërem Refat Beçi Hajdar Iljaz Pleshti
Maqo Dosi Anastasi Servet Hamdi Pasho
me këtë motivacion:

«Për vendosmëri dhe guximin e madh të treguar në punimet e rëndësishme për shuarjen e zjarrit dhe mbylljes së erupzionit në pusin 542, në këtë vepër të rëndësishme për ndërtimin e socializmit në vendin tonë».

Ali Mersin Spaho Latif Islam Fejziu
Rustem Rrapo Ahmetaj Shaqir Kadri Hasanaj
me këtë motivacion:

«Janë dalluar në drejtimin e repartit, në organizimin e mirë të punës, në përdorimin maksimum të teknikës, për shuarjen e mbylljen e pusit me erupzion nr. 542, vepër me rëndësi për ndërtimin e socializmit në vendin tonë».

III. ME' URDHËRIN E PUNËS TË KLASIT III-të

Gelgast Jakov Aronoviç Kozllov Valentin Aleksandroviç
Surkov Valeri Timfejeviç
me këtë motivacion:

«Kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në punë për shuarjen e zjarrit dhe mbylljen e pusit me erupsion nr. 542 dhe kanë punuar me vëtmohim».

Dhos Kristo Odriçani
Agim Avni Fortuzi
Dhimitër Prokop Lele
Ilo Miti Pando
Lame Miti Koçi
Ilia Toli Xhaxhallari
Hysen Shefqet Sokoli
Novrus Myrteza Belba
Niko Foro Goxhobashi
me këtë motivacion:

Rapo Selfo Hazizi
Hysen Sadik Gjoroveni
Muhedin Allanjaku
Selim Seraj Deliu
Thanas Mihal Jorgji
Xhemal Tahir Serniqi
Nazif Neim Avdo
Sotir Terpini
Thanas Spiro Merkuri

«Janë treguar të gatshëm, të palodhur dhe organizues të mirë në punimet për shuarjen e zjarrit në pusin 542 si dhe në mbylljen e tij nga erupsioni».

Sulo Refat Backa
Harif Zezir Zhura
Kozma Llazi Mile
Thanas Ilia Martini
Hysen Ibrahim Meçani
Veip Halil Likaj
Hamdi Ali Meda
Mitat Kalem Hyseni
Aqif Mehdi Ebibasi
Ramazan Razim Bali
Demir Kasëm Agalliu
me këtë motivacion:

Besim Asllan Sadiklli
Haki Marika
Ahmet Zyber Tataveshi
Mihal Jani Niçko
Mystehak Xhemal Selaj
Nevrus Jashar Karaj
Hasan Mersin Merko
Kadri Ramadan Hoxha
Miho Sholla
Kujtim Dino Skënderi
Sulo Allanjaku

«Janë treguar të palodhur në drejtimin e repartit, në shfrytëzimin e mirë të teknikës, në organizimin e mirë të punës për shuarjen e zjarrit dhe mbylljen e erupzionit të pusit 542, duke kontribuar kështu në përfundimin me sukses të kësaj vepre».

IV. ME MEDALJEN E PUNËS

Ali Sinan Bilani
Abib Teki Zotaj
Abas Meta Jaipi
Baftiar Sulejman Basho
Bajram Hajdar Bajrami
Celo Ali Muho
Jasim Xhemal Aruni
Haki Jashar Hoxha
Hysen Hazbi Rama
Dervish Maliq Sinani
Halil Osman Osmani
Kadri Alim Pajo
Nuri Dajlan Velmishi
Rapo Hamit Celati
Ramis Sako Hoxha
Sali Tefik Dervishi
Mihal Thanas Dani
Teki Bazo Goxhaj
Sami Iljaz Resuli
Katina Lazar Miloti
Myslim Jonuz Mesutaj
Konstandin Kristo Riva
Ramiz Jashar Cela
Tefik Shahin Shenaj
Thoma Kristo Riva
Rasim Kadri Majko
Gjysho Fejzi Isufaj
me këtë motivacion:

Sado Tefik Shpata
Rapush Sali Bardhi
Merques Melan Bega
Fatmir Riza Bezhraj
Qamil Hasan Hoxha
Pandi Ndini Koçi
Jani Anastas Fani
Sokrat Koli Pitushi
Thimi Lili Sinjari
Ismail Gani Agalliu
Gani Ibrahim Hyseni
Panajot Kristo Ceveli
Jorgji Kici Karaja
Leonidha Aleko Ekonomi
Petro Kozma Shalla
Simon Agostin Xhepeli
Muhamrem Izet Salaij
Xhelal Avdulla Kona
Tafil Duke Braka
Xhemal Jonuz Dibra
Banush Rafik Agastru
Karafil Ibrahim Balo
Kozma Nasi Koroveshi
Jani Dhimitër Mitulli
Caco Hasan Spahiu
Hysni Mitat Zurbo

«Gjatë kohës së punimeve për shuarjen e zjarrit dhe mbylljen e pusit nr. 542 janë mobilizuar me të gjitha forcat e tyre duke dhënë kështu një ndihmë të çmuar në përfundimin me sukses të kësaj vepre».

Server Selman Bashkllari	Subi Ramadan Bakillari
Hasan Seit Jahaj	Nuredin Mimin Luaraku
Zarik Stambolliu	Zef Pal Berhani
Pandeli Vasil Blaca	Selman Ramazan Kallmeti
Sefer Avdulla Hyka	Feta Maliq Minga
Gani Hymer Shehu	Qemal Hasa Mallosi
Riza Kasem Resuli	Sali Bajram Avdija
Hibrahim Hazis Matarangasi	Qazim Sulejman Baloshi
Selman Osman Kovaçi	Abedin Vebi Collolli
Hasim Beqir Kanani	Izet Ali Alikaj
Rasho Deli Atimuca	Vangjel Jorgji Buzo
Shyqyri Tahir Jeshili	Qazim Ramadan Leka
Ahmet Rakip Mujka	Bajram Avdulla Rizaj
Avdulla Mustafa Fica	Kapo Islam Lame
Tasi Miti Furxhiu	Shaban Kasem Zaimi
Reshit Hasim Bengu	Hatem Shaqir Shaqiri
Neshat Bajram Kore	Beshir Mustafa Beshiri
Gani Xhemal Loze	Elmas Emin Dauti
Njazi Shefit Dervishi	Tafil Jaup Hajdari
Pjetër Vat Bega	Haxhem Daut Hameti
Dervish Osman Doku	Neki Kaçaniku
Mazllan Firit Pocani	Koço Pulla Thonore

me këtë motivacion:

«Janë treguar të aftë për realizimin e detyrave të ngarkuara në shuarjen e zjarrit dhe mbylljen e erupsionit të pusit 542 duke kontribuar kështu për përfundimin me sukses të kësaj vepre».

V. ME MEDALJEN PËR TRIMËRI NË PUNË

Ali Llano Miftari
Abib Zenel Pashaj
Ahmet Tefik Muska
Andon Lili Kola
Bilal Tejko Ruka
Durke Rapush Brahimi
Dine Nuredin Elshani
Idris Sabri Bregu
Jani Jorgji Kocani
Hekuran Hysen Ademi
Koli Nasi Mane
Myslim Arif Meli
Ilia Vangjel Minella
Nesim Fetash Xhaxhaj
Kristo Jani Rushi
Namik Isuf Alimanı
Rrapo Selfo Asizaj
me këtë motivacion:

«Me vullnetin e tyre të fortë dhe të pa epur kanë rezistuar për shuarjen e zjarrit dhe mbylljen e erupsionit në pusin 542. Kanë punuar në kondita pune shumë të vështira, guximi dhe trimëria e të cilëve, bëri që punimet e pusit të përfundojnë me sukses».

Dilaver Qazim Caka
Qemal Muhamet Hoxha
Sami Atif Hajdari
Tefik Ibrush Brahushi
Pandi Vani Koka
Selaudin Hetem Zhura
Neki Rexhep Xhengo
Ajvaz Mahmut Gaushi
Samedin Troka

Fetah Ahmet Sulejmani
Koço Nikolla Reçi
Qazim Gani Shehu
Rifat Miho Arumi
Pandi Vani Koka
Todi Jani Vogli
Tefik Ferat Karamani
Shefik Murat Toptani
Zenel Hekuran Harapi
Zenel Gure Kalemi
Shaban Zenel Rapaj
Thodhor Andon Vero
Zenel Hajdar Mahmutoaj
Ymer Nexhip Xhaferi
Andon Koci Capo
Dalip Shuain Ferko
Rapush Ali Zeka

Ismail Muharrem Basha
Metush Muha Kotori
Bari Sulejman Çuni
Kasem Xhelil Resulaj
Hydai Hajdar Dalipi
Hekuran Kasem Tosku
Pandeli Koxi Komoni
Kadri Ismail Xhemali
Shahin Ramazan Tabaku

Ibrahim Mehmet Shabani
Kamber Mustafa Kafexhiu
Hasan Selim Hyka
Shyqeri Banush Latifi
Selman Ramo Hysi
Sherif Hetem Ahmetllari
Halil Osman Vari
Besim Avdulla Behari
Nuredin Avdulla Cerozi
Jorgo Jani Nano
Laver Muharem Fejzo
Mystehak Brahim Dervishi
Asllam Haxhi Celibashi
Ramadan Kerkut Isufi
Besim Hekuran Guri
Musa Isuf Doraci
Ilmi Tefik Agolli
Todi Spiro Polena
Xhevitet Tahir Sula
Mefail Tosun Sadikaj
Hazis Qazim Peqini
Sedat Tahir Elmazi
Pilo Kozma Xhaho
Petro Jani Karoqi
Shaquo Tariat Nevra
Gjergji Petro Nako
Tajar Ceno Rapushi
Drumish Hysen Durmishi
Xhemal Bajram Maloku
Lazi Aleks Dhimo
me këtë motivacion:

Sefudin Baburi
Sami Tefik Muhameti
Ramazan Idrizi
Qamil Bajram Muça
Zef Marashi
Nexhat Myslym Hysolli
Pandi Noni
Nexhdet Tefik Xhaholli
Musa Alia
Sotir Lame Bitri
Lluka Thimi Jorgji
Osman Ramazan Nuka
Thoma Xhaxhi Meçi
Kadri Mustafa Gabi
Qazim Ethem Çela
Ibrahim Bilimani
Gaço Llambi Çoçi
Agim Avdul Shkembi
Fiqiri Avdul Kashari
Mustafa Dalip Bregu
Gani Avdulla Genjeri
Sabri Kamber Shinko
Rapush Qamil Bajrami
Jonus Jamos Çeliku
Mustafa Tahir Mamaqi
Hasan Zeqir Kepi
Plumb Çeço Rustemi
Jakup Osman Dervishi
Rexhep Selman Dushku

«Kanë treguar zotësi dhe trimëri në punë, për shuarjen e zjarrit dhe mbylljen e erupzionit të pusit 542 duke kontribuar kështu në përfundimin me sukses të kësaj vepre».

VI. ME MEDALJEN E SHËRBIMIT USHTARAK

Ahmet Meçan Lloj Mufit Jaçe Shabani
Pelinan Islam Bendaj Ligor Kordhima
Rato Hasan Peçi Gani Myrstehak Vajsa

me këtë motivacion:

«Kanë treguar zotësi dhe trimëri në punë, për shuarjen e zjarrit dhe mbylljen e erupsionit të pusit 542 duke kontribuar këshfu në përfundimin me sukses të kësaj vepre.»

Tiranë, me 19/VII/1957

Dekret Nr. 2488

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI Sami Beholli **KRYETARI** Haxhi Lleshi

ПРАВЫЕ ДЕКРЕТЫ ПРАВИТЕЛЬСТВА

über akordim titulli

«HERO I PUNÈS SOCIALISTE»

„Në mbështetje të nenit 58, pika d, të Kushtetutës së Republikës popullore të Shqipërisë,

Me propozimin e Qeverisë

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
U JEP TITULLIN «HERO I PUNËS SOCIALISTE»

Haki Selman Gjondedaj

Mendu Abil Backa

me këtë motivacion:

«Ka kryer akte heroizmi dhe ka treguar devotshmëri
dhe trimëri të rrallë në zbatimin e detyrës në tërheqjen e
eksplozivit nga zjarri me shpërthimin e dinamitit, duke
ja harritur kështu mbylljes së erupzionit të pusit Nr. 542».

Qemal Qamil Mahmuti,

me këtë motivacion:

«Është dalluar për veprimitari të jashtëzakonëshme
dhe vëtmohuese duke punuar në kushte shumë të vështira,
për çimin, shuarjen e zjarrit dhe mbylljen e erupzionit
në pusin Nr. 542 dhe për vënien e tij në shfrytëzim.»

Tiranë, me 19/VII/1957

Dekret Nr. 489

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI

Sami Baholli

KRYETARI

Haxhi Lleshi

Tirazhi: 3000

STASH: 2204-55

U shtyp në Stabilimentin «MIHAL DURI» — Tiranë, 1958